



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-038

Prishtinë, më 25 tetor 2011, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 25 TETOR 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Glauk Konjufca dhe Petar Miletiq, nënkryetarë të Kuvendit,

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Duda Balje.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi dhe Eshref Vishi,

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca,

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj,

Nga: OSBE: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe tri pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Njoftimi i kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, lidhur me debatin parlamentar për Raportin e Progresit 2011 për Kosovën, si dhe për Interpelancën lidhur me situatën politike dhe të sigurisë në pjesën veriore të Kosovës.
2. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Njoftimi i kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, lidhur me debatin parlamentar për Raportin e Progresit 2011 për Kosovën, si dhe për Interpelancën lidhur me situatën politike dhe të sigurisë në pjesën veriore të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me njoftimin e kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, lidhur me debatin parlamentar për Raportin e Progresit 2011 për Kosovën, si dhe për Interpelancën lidhur me situatën politike dhe të sigurisë në pjesën veriore të Kosovës, vendosi që Kuvendi t'i mbajë dy mbledhje plenare, më 27 tetor 2011 dhe më 8 nëntor 2011.

Mbledhja plenare, më 27 tetor 2011, me këtë:

Rend dite

1. Interpelancë e Kryeministrit të Qeverisë të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi lidhur me situatën politike dhe të sigurisë në pjesën veriore të Republikës së Kosovës, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Mbledhja plenare, më 8 nëntor 2011, me këtë:

Rend dite

1. Debati parlamentar me Kryeministrin e Qeverisë të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, lidhur me Raportin e Progresit 2011 për Kosovën, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së.

2. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe të kërkesave

2.1 Kërkesa e Komisionit për Rregullore të Kuvendit, për vizitë zyrtare në Turqi

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i anëtarëve të Komisionit për Rregullore të Kuvendit, në këtë përbërje: Armend Zemaj, Behar Selimi, Albulena Haxhiu, Ardian Gjini, Mufera Sinik, Jasmina Zhivković dhe Amir Ahmeti, si dhe Eshref Vishi, këshilltar i Kryetarit të Kuvendit, Sali Rexhepi dhe Advije Morina, nga Administrata e Kuvendit, për vizitë studimore në Parlamentin Kombëtar të Turqisë, prej datës 31 tetor 2011 deri më 04 nëntor 2011.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurit në paragrafin një (1) të këtij vendimi i bart organizatori - TIKA, ndërsa mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

2.2 Kërkesa e Komisionit për Legjislacion, për vizitë zyrtare në Shqipëri

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i anëtarëve të Komisionit për Legjislacion: Arben Gashi, Behar Selimi, Mufera Sinik, Arsim Bajrami, Halit Krasniqi, Haki Demolli, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu, Ardian Gjini, Amir Ahmeti dhe Jasmina Zhivković, si dhe Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi, nga Administrata e Kuvendi, për vizitë studimore në Shqipëri, prej datës 08 deri më 12 nëntor 2011.

2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të qëndrimit dhe mëditjet për të lartpërmendurit në paragrafin një (1) të këtij vendimi përballohen nga buxheti i Kuvendit, në përputhje me vendimin e Kryesisë së Kuvendit.

2.3 Ftesa e Universitetit “KRISTAL” në Shqipëri, për disa deputetë të Kuvendit

Kryesia, pasi shqyrtoi ftesën e cekur më lartë, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i deputetëve të Kuvendit, në përbërje: Xhavit Haliti, Lutfi Haziri, Albin Kurti dhe Ahmet Isufi, për të marr pjesë në Konferencën e organizuar nga Universiteti “KRISTAL”, me temën: “Sfidat politike të Republikës së Kosovës”, që do të mbahet në Tiranë, prej datës 27 - 28 tetor 2011.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit, të ushqimit dhe mëditjet shtesë për të lartpërmendurit në paragrafin një (1) të këtij vendimi, mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **13:50** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.